# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6313
E hënë, 17 maj 2021
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

## Pse autostradat e Kosovës janë pa pagesë?

FAQE 5



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA ËSHTË LARG KONSENSUSIT NACIONAL PËR DIALOGUN ME SERBINË FAQE 4-5

# DIALOGU ME SERBINË PRITET TË RINISË PA KONSENSUS NACIONAL

Qeveria e Kosovës në muajin qershor pritet ta rinisë dialogun me Serbinë pa pasur një konsensus nacional për këtë proces. Partitë opozitare, ndonëse përkrahin vazhdimin e dialogut me Serbinë, janë shprehur kundër përfshirjes së drejtpërdrejtë në këtë proces. Teksa kanë kritikuar qasjen e qeverisë për këtë proces, përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se kontributin e tyre për këtë proces do ta japin në Kuvendin e Kosovës. Njohësit e këtij procesi dhe shoqëria civile kanë bërë me dije se konsensusi nacional për këtë çështje është shumë i nevojshëm për Kosovën




## RRETH 40 MIJË QYTETARË NË KOSOVË KANË MARRË VAKSINËN KUNDËR COVIDIT

FAQE 3

Vaksinimi kundër Covid-19 është duke vazhduar për qytetarët e moshës mbi 65-vjeçare të regjistruar në e-kosova dhe sipas terminëve të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Numri i përgjithshëm i qytetarëve të vaksinuar deri më tani është rreth 40 000. Në Kosovë ka vazhduar trendi i përmirësimit të situatës epidemiologjike, pasi të dielën pozitivë me Covid kanë dalë 71 persona nga 3 377 mostra të testuara, ndërkaq kanë humbur jetën nga ky virus edhe dy persona



## ULQINI NË KËTË SEZON OFRON ULJE ÇMIMESH DHE SHMANGIE TË PRITJEVE KUFITARE

FAQE 8-9

### AKTUALE



PAPA FRANÇESKU BËN THIRRJE TË NDALEN LUFTIMET NË IZRAEL DHE GAZA F. 2

ÇËSHTJA E UKSHIN HOTIT DHE E TË ZHDUKURVE TË TJERË TË TRAJTOHET NË DIALOG F. 7

TAHIRI KËRKON NGA QEVERIA TË MOBILIZOHET KUNDËR DHUNËS SEKSUALE F. 6

### EKONOMI

DOGANA PËR KATËR MUAJ MBLODHI RRETH 400 MILIONË EURO, SHPEJT NIS ZHDOGANIMI I MALLRAVE NË DURRËS F. 9

### KULTURË

HËNA ABDULLAHI, VIOLINISTJA E TALENTUAR QË SYNON SKENAT BOTËRORE F. 9



### SPORT

NUHIU TËRHIQET NGA PËRFAQËSUESJA E KOSOVËS F. 9

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Papa Françesku bën thirrje të ndalen luftimet në Izrael dhe Gaza





Vatikan, 16 maj - Papa Françesku bëri thirrje të dielën për t'i dhënë fund konfliktit në Izrael dhe Gaza, duke thënë se vdekjet e kaq shumë njerëzve të pafajshëm ditët e fundit, përfshirë fëmijët, ishin të papranueshme. "Unë apeloj për qetësi dhe ata që janë përgjegjës t'i japin fund përdorimit të armëve dhe të drejtohen në rrugën e paqes", ka thënë ai në një fjalim të përjavshëm për besimtarët e mbledhur në sheshin "Shën Pjetri". "Shumë njerëz të pafajshëm kanë vdekur, mes tyre ka edhe fëmijë. Kjo është e tmerrshme. E papranueshme. Vdekja e tyre është një shenjë se njerëzit nuk duan të ndërtojnë një të ardhme, por po e shkatërrojnë atë. Pyes veten se ku mund të çojë urrejtja dhe hakmarrja?", ka thënë Papa.

Mjekët palestinezë thonë se numri i të vdekurve nga sulmet ajrore izraelite në Gaza të dielën ka arritur në 33. Ky është numri më i madh i viktimave që nga fillimi i luftimeve.

Më 16 maj, ushtria izraelite ka njoftuar se ka kryer sulme ajrore në shtëpinë e Yahya Sinwar, kreu i krahut politik të Hamasit në Rripin e Gazës. Ushtria nuk bëri me dije nëse ai u vra.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se fushata aktuale kundër militantëve palestinezë "do të vazhdojë për aq kohë sa nevojitet" me gjithë thirrjet për qetësi nga Uashingtoni dhe Kombet e Bashkuara.

Netanyahu është zotuar se do të "vazhdojë të përgjigjet me forcë" ndaj sulmeve me raketa derisa konflikti me palestinezët në Gaza hyri në ditën e shtatë.

Militantët palestinezë qëlluan me raketa drejt Tel Avivit, duke bërë që njerëzit atje të largoheshin në strehimore.

Grupet e armatosura palestineze kanë shkrepur të paktën 2 300 raketa në drejtim të Izraelit që nga fillimi i përshkallëzimit të dhunës.

Komuniteti ndërkombëtar ka bërë thirrje për t'i dhënë fund konfliktit të përshkallëzuar. Të dielën vonë Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të zhvillojë një takim.

Grupi militant islamik Hamas filloi sulmin me raketa në Izrael pas disa javësh tensionesh në Jerusalem mes palestinezëve dhe izraelitëve.

Sulmet pasuan kundërshtimet për një çështje gjyqësore për t'i dëbuar disa familje palestineze në Jerusalemin Lindor dhe në shenjë hakmarrjeje për përplasjet e policisë izraelite me palestinezët pranë xhamisë Al-Aksa të qytetit, vendi i tretë më i shenjtë i Islamit.

Izraeli në shenjë hakmarrjeje nisi sulme ajrore dhe artilerie në Gaza.

# Turqia lehtëson disa masa të izolimit



Ankara, 16 maj - Të dielën Ministria e Brendshme e Turqisë ka shfuqizuar masën e izolimit të plotë që ishte vendosur për ta parandaluar përhapjen e Covid-19.

Në vendimin e ri, që nis të zbatohet nga e hëna deri më 1 qershor, ministria ka njoftuar se synon të arrijë një "normalizim gradual".

Qendrat tregtare do të jenë në gjendje të rihapen ndërsa disa biznese do të mbesin të mbyllura, përfshirë palestrat dhe kafenetë, por restorantet do të jenë në gjendje ta ofrojnë shërbimin "merr me vete". Pastaj, procesi mësimor për parashkollorët do të rinisë në objekte, por klasat e larta do ta vazhdojnë mësimin në distancë.

Turqit mund të kthehen në vendet e tyre të punës, por do të duhet të qëndrojnë në shtëpi nga ora 21:00 deri në 5.00 të mëngjesit gjatë ditëve të javës dhe gjithë ditën e shtunë dhe e diel. Nëpunësit civilë do të vazhdojnë të punojnë në distancë ose në ndërrime në zyra. Nga vendimi përjashtohen turistët dhe punëtorët e huaj me leje speciale.

Qytetarët e moshuar të pavaksinuar mbi 65 vjeç do të lejohen të dalin nga shtëpitë e tyre vetëm nga ora 10:00 e mëngjesit deri në orën 2:00 pasdite, gjatë ditëve të javës.

Turqia hoqi disa kufizime në muajin mars duke bërë që numri i të infektuarve me koronavirusin e ri të rritet. Në muajin prill autoritetet vendosën masën e izolimit të plotë pas regjistrimit të deri në mbi 60 000 raste në ditë.

Të shtunën u raportuan 11 472 raste të reja me koronavirus.

Që nga fillimi i pandemisë, ky vend ka shënuar 44 537 vdekje nga sëmundja Covid-19 që e shkakton koronavirusi i ri.

# Vuçiqi: Ndryshimi i kufijve është i mundur vetëm nën mandatin e OKB-së

Beograd, 16 maj - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se ai është kundër ndryshimit të kufijve, por kjo ide, sipas tij, do të mund të gjente zbatim vetëm nëse do të mandatohej nga Kombet e Bashkuara ose një institucion tjetër. "Ndryshimi i kufirit është i mundur vetëm nën mandatin e Kombeve të Bashkuara ose ndonjë institucioni tjetër", ka deklaruar Vuçiq për televizionin "TV Prva", duke shtuar se pozicioni i Serbisë bazohet në respektimin e ligjit ndërkombëtar.

Gjatë javëve të fundit mediat në rajon, por edhe më gjerë, kanë shkruar për idetë për ndryshimin e kufijve të vendeve në rajonin e Ballkanit si mundësi për t'i zgjidhur çështjet e mbetura si të pazgjidhura nga procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Mediat në Bosnje e Hercegovinë dhe në Slloveni kanë shkruar se për këto ide kryeministri slloven Janez Jansha, vendi i të cilit merr së shpejti edhe kryesimin e radhës të BE-së, kishte dorëzuar në Bruksel një "non paper".

Por, në BE kanë thënë disa herë se "nuk e kanë parë një letër të tillë".

Disa shtete të BE-së, më së shumti Gjermania, janë shprehur kundër ideve të tilla duke i quajtur të rrezikshme.

Në gjuhën e institucioneve evropiane, non-paper është një



dokument joformal, i cili ekspozohet në negociata të mbyllura brenda institucioneve të BE-së, në përpjekje për të gjetur marrëveshje për ndonjë çështje të kontestuar.

Ndërkohë Sllovenia, më 17 maj, do të jetë nikoqire e samitit të presidentëve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, i njohur si Procesi Bërdo-Brioni.

Vuçiç ka thënë se pas takimit të nivelit të lartë ai do ta vizitojë Brukselin.

Bërdo-Brioni është një nismë e presidentëve të Sllovenisë dhe të Kroacisë, si dy shtete anëtare të BE-së, i cili synon forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe nxitjen e dialogut politik midis rajonit të Ballkanit dhe BE-së.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Rreth 40 mijë qytetarë në Kosovë kanë marrë vaksinën kundër Covidit



Vaksinimi kundër Covid-19 është duke vazhduar për qytetarët e moshës mbi 65-vjeçare të regjistruar në e-kosova dhe sipas terminëve të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Numri i përgjithshëm i qytetarëve të vaksinuar deri më tani është rreth 40 000. Në Kosovë ka vazhduar trendi i përmirësimit të situatës epidemiologjike, pasi të dielën pozitivë me Covid kanë dalë 71 persona nga 3 377 mostra të testuara, ndërkaq kanë humbur jetën nga ky virus edhe dy persona

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 16 maj** - Bazuar në raportet nga klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe në spitalet e përgjithshme, pacientë të shtrirë, si pasojë e infektimit me Covid-19, janë 292, 187 janë të konfirmuar me Sars-Cov-2 pozitivë, 17 pacientë janë në gjendje të rënduar shëndetësore dhe 218 janë nën asistim të okisgjeno-terapisë.
Vaksinimi kundër Covid-19 ka vazhduar për qytetarët e moshës mbi 65 vjeç të regjistruar në e-kosova dhe sipas terminëve të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Gjatë dy ditëve të fundit janë vaksinuar 7 742 qytetarë me vaksinën kundër Covid-19, derisa numri i përgjithshëm i qytetarëve të vaksinuar deri më tani është 39 321 persona.
"Vaksinimi po vazhdon përmes përcaktimit paraprak të terminëve për qytetarët të cilët janë regjistruar dhe kanë aplikuar përmes platformës e-kosova, të cilët kontaktohen dhe ftohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga QKMF-të në komuna, sipas listave të tyre në dispozicion. Ditëve në vijim MSh do të krijojë mundësi të tjera shtesë për regjistrim e të gjithë qytetarëve që duhet të vaksinohen deri në arritjen e objektivit të vaksinimit të rreth 60 për qind të popullatës së Kosovës", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.
Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 377 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 71 raste pozitive me Covid-19.
Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të të vdekurve. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Mitrovicë një rast (81 vjeç), Podujevë një rast (59 vjeç).
Numri total i rasteve pozitive është 106 914 raste nga 568 984 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 225 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 173 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 99 628 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5,061.
Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 25 raste, Gjilan 9 raste, Mitrovicë 7 raste, Ferizaj 5 raste, Istog 3 raste, Obiliq 3 raste, Pejë 3 raste, Fushë-Kosovë 2 raste, Gjakovë 2 raste, Klinë 2 raste, Podujevë 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Kamenicë, Lipjan, Prizren, Rahovec dhe Suharekë.

# MPJ e Kosovës: Izraeli ka të drejtë të mbrohet nga Hamasi

**Prishtinë, 16 maj (ER)** - Ministria e Jashtme e Kosovës (MPJ) ka thënë se Izraeli ka të drejtë dhe detyrim ta mbrojë popullin e vet kundër 2 000 raketave të shkrepura ndaj civilëve, vetëm nga Hamasi.
Ky është reagimi i parë zyrtar i Kosovës që nga përshkallëzimi i dhunës mes Izraelit dhe grupit militant Hamas që udhëheq Rripin e Gazës, gjashtë ditë më parë. Duke shprehur pikëllim për të gjitha viktimat, në reagimin e Ministrisë së Jashtme të Kosovës vlerësohet se Hamasi po mban civilët palestinezë si pengje të luftës së tij.
MPJ u bënë thirrje palëve të përfshira në konflikt për përmbajtje, ndalje të dhunës dhe për arritjen e një zgjidhjeje paqësore.
Shpërthimi i dhunës gjatë gjashtë ditëve të fundit pasoi pas disa javë tensionesh në rritje në Jerusalemin Lindor, që kulmuan me përleshje në një vend të shenjtë të nderuar nga myslimanët dhe hebrenjtë.
Hamas - grupi militant palestinez që drejton Gazën - filloi të lëshonte raketa pasi paralajmëroi Izraelin të tërhiqej nga vendi, duke shkaktuar sulme ajrore hakmarrëse izraelite.
Që nga fillimi i luftimeve të paktën 148 njerëz janë vrarë në Gaza, sipas zyrtarëve palestinezë, dhe Izraeli ka raportuar 10 të vdekur, përfshirë dy fëmijë. Izraeli thotë se dhjetëra militantë janë midis të vdekurve në Gaza, ndërsa zyrtarët palestinezë të shëndetësisë thonë se numri i të vdekurve përfshin 41 fëmijë.
Komuniteti ndërkombëtar ka bërë thirrje për t'i dhënë fund konfliktit të përshkallëzuar. Të dielën vonë Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të zhvillojë një takim.






KOSOVA ËSHTË LARG KONSENSUSIT NACIONAL PËR DIALOGUN ME SERBINË

# Dialogu me Serbinë pritet të rinisë pa konsensus nacional

Qeveria e Kosovës në muajin qershor pritet ta rinisë dialogun me Serbinë pa pasur një konsensus nacional për këtë proces. Partitë opozitare, ndonëse përkrahin vazhdimin e dialogut me Serbinë, janë shprehur kundër përfshirjes së drejtpërdrejtë në këtë proces. Teksa kanë kritikuar qasjen e qeverisë për këtë proces, përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se kontributin e tyre për këtë proces do ta japin në Kuvendin e Kosovës. Njohësit e këtij procesi dhe shoqëria civile kanë bërë me dije se konsensusi nacional për këtë çështje është shumë i nevojshëm për Kosovën

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 MAJ - Ndonëse janë shprehur pro vazhdimit të dialogut me Serbinë, pozita dhe opozita vështirë së do të arrijnë një konsensus nacional për këtë çështje. Qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmëri për ta përfshirë opozitën në këtë proces, por kjo e fundit është shprehur kundër përfshirjes së drejtpërdrejtë në dialogun me Serbinë. Partitë opozitare kanë thënë se kontributin e tyre në këtë proces do ta japin në Kuvendin e Kosovës.

Qeveria e Kosovës në programin e saj e ka paraparë si prioritet këtë proces, duke thënë se synimi i dialogut është njohja reciproke. "Qeveria e Kosovës angazhohet në dialogun me Serbinë me synim normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve dypalëshe. Dialogu me Serbinë zhvillohet për adresimin e çështjeve ndërshtetërore dhe fqinjësisë së mirë dhe ka orientim kryesor përfitimet e qytetarëve nga rezultatet e dialogut ndërshtetëror. Marrëveshja finale e synuar do të ketë brenda të gjitha çështjet e pazgjidhura që nga sukcesioni i ish-Federatës Jugosllave në të cilën Kosova ishte element konstituiv. Marrëveshjet e deritanishme do të trajtohen për ta parë shkallën e përmbushjes dhe ndikimin e tyre", është thënë në programin e qeverisë të miratuar javën e kaluar.

Në këtë dokument parashihet edhe bashkëpunimi me opozitën. "Me opozitën do të bashkëbisedojmë rregullisht për të ndërtuar konsensus nacional në përgjithësi sa i përket politikës së jashtme, në veçanti për raportin me Serbinë. Qeveria e Kosovës do të marrë pjesë në dialogun me Serbinë me parime të qarta dhe me qëllimin që marrëveshja finale, përveç çështjeve ndërshtetërore, do ta përfshijë edhe njohjen reciproke mes shteteve, njohjen nga pesë vendet e mbetura të BE-së si dhe anëtarësimin në OKB", është thënë në programin e qeverisë.

Por, opozita ka kritikuar qasjen e qeverisë karshi procesit të dialogut me Serbinë.

Nënkryetarja e LDK-së, Shqipe Mjekiqi, ka thënë se në programin e qeverisë nuk përmenden fare parimet e dialogut me Serbinë. "Qeveria nuk e ka paraqitur kornizën e parimeve për dialogun me Serbinë që, sipas LDK-së, duhet të përfundojë me njohjen reciproke të të dyja vendeve në kufijtë aktualë pa cenuar rendin kushtetues të vendit. Këto parime që po i theksojmë nuk përmenden fare në programin e qeverisë", ka thënë ajo në një konferencë për media.

Sipas saj, mungesa e parimeve në këtë proces mund të jetë e dëmshme për Kosovën. "Në program vetëm aludohet në 'parime të qarta'. Mungesa e parimeve lë hapësirë për aranzhmane të mundshme të cilat dobësojnë pavarësinë e shtetit të Kosovës. Meqenëse pritëm 50 ditë, do të kishim dashur të thoshim se kjo pritje ia ka vlejtur por, në fakt, është e kundërta", ka deklaruar Mjekiqi.

Partia më e madhe opozitare, PDK-ja, ka mohuar se mund të bëhet pjesë e ndonjë delegacioni të qeverisë për këtë proces.

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë për "Epokën e re" se kjo parti do ta japë kontributin e saj për këtë proces në Kuvendin e Kosovës. Ai ka bërë me dije se deri më tani PDK-ja nuk ka pasur kurrfarë oferte për t'u përfshirë në dialogun me Serbinë. "E thashë se PDK-ja do ta japë kontributin e saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne nuk kemi kurrfarë oferte konkrete në këtë drejtim, por në këtë situatë ne jemi parti opozitare dhe kontributin tonë do ta japim në Kuvendin e Kosovës. Pra, aty do ta mbrojmë interesin e Kosovës", ka thënë Hamza.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se në çfarë kushtesh e përkrah vazhdimin e dialogut me Serbinë. Sipas tij, AAK-ja e vlerëson të domosdoshëm lidershipin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun Kosovë - Serbi. "Si parti opozitare ne do ta kryejmë obligimin tonë për çështjen e dialogut ashtu siç jemi zotuar para qytetarëve të vendit, gjithnjë në mbrojtje të interesave nacionale. Në takimin e sotëm, ritheksuam domosdoshmërinë e rolit udhëheqës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë proces me shumë rëndësi për vendin tonë, prej të cilit presim njohje reciproke, me marrëveshje obliguese ligjore, në kufijtë ekzistues, dhe paprekshmërinë e organizimit të brendshëm kushtetues të Republikës së Kosovës", ka thënë Haradinaj.

### Konsensusi nacional është i nevojshëm

Njohësit e procesit të dialogut dhe shoqëria civile kanë ftuar pozitën dhe opozitën që të bashkëpunojnë në raport me dialogun me Serbinë. Sipas tyre, konsensusi nacional për këtë çështje është i nevojshme. "Janë disa çështje që duhet të bashkojnë pozitën dhe opozitën. Nëse nuk bashkohen, jemi larg nga interesat kombëtare", ka deklaruar ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri.

Ditë më parë edhe KDI-ja i ka ftuar bartësit e institucioneve që, krahas hartimit të strategjisë dhe platformës për dialogun, të ndërmarrin hapa konkretë drejt

arritjes së konsensusit të gjerë politik për dialogun, me qëllim për ta forcuar pozicionin e Republikës së Kosovës në këtë proces. "Në këtë drejtim, kryeministri dhe presidentja, konform përgjegjësive të tyre kushtetuese, duhet ta iniciojnë dhe t'i kontribuojnë ndërtimit të konsensusit politik lidhur dialogun. Ndërsa subjektet opozitare duhet të jenë të përgjegjshme për arritjen e konsensusit për këtë çështje të interesit shtetëror, duke treguar përkushtim dhe konstruktivitet për tejkalimin e pengesave për arritjen e pajtueshmërisë", ka vlerësuar KDI-ja.

Kurse politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se qeveria duhet t'i koordinojë takimet brenda dhe jashtë vendit për të kaluar në ofensivë në këtë proces. "Z. Kurtin asnjë arsyetim për shmangie nga vazhdimi i dialogut nuk e justifikon. Kosova duhet të kooperojë dhe koordinojë takimet brenda dhe jashtë për të kaluar nga defansiva e trashëguar në ofensivë diplomatike duke promovuar superioritetin e argumenteve në dialog karshi Serbisë", ka thënë Beqaj. Sipas tij, Kurti duhet të jetë i hapur me partnerët ndërkombëtarë dhe duhet t'i pranojë obligimet e mëparshme të procesit të dialogut. "Z. Kurti duhet të jetë i hapur para zyrtarëve evropianë për gatishmërinë e qeverisë për ta implementuar obligimin e trashëguar nga pushtetet e mëparshme, pavarësisht se LV-ja e ka kundërshtuar formimin e AKS-së. Qeveria Kurti duhet të angazhohet për vazhdimin e dialogut për aq sa ka gatishmëri të palëve për të shkuar në drejtim të njohjes reciproke. Nëse palët ngulin këmbë vetëm për 'normalizim' dhe 'ndërmjetësim dhe lehtësim' të vazhdimit të dialogut, ai duhet të sillet konform rrethanave", është shprehur Beqaj.

Deri më tani Qeveria e Kosovës ka bërë me dije se në dialogun me Serbinë do të përfshihen disa ekspertë nga shoqëria civile.

Në bazë të një memorandumi që Grupi për Ballkan ka me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ambasadën e Norvegjisë parashihet që ekspertët e angazhuar deri më tani janë Bernard Nikaj, Leon Malazogu, Robert Muharremi, Muhamet Mustafa, Veton Surroi. Së shpejti grupit të ekspertëve pritet t'i bashkohet edhe Blerim Shala.

Rinisja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë para fundit të qershorit. Kështu ka thënë përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pas takimit në Bruksel që ka pasur me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

# Pse autostradat e Kosovës janë pa pagesë?

**Prishtinë, 16 maj** - Autostradat në Kosovë vazhdojnë të jenë pa pagesë, kurse ato mirëmbahen nga buxheti i shtetit. Në buxhetin e Kosovës për vitin 2021 për mirëmbajtjen e rrugëve janë ndarë mbi 19 milionë euro. Ndërkohë, pagesa e udhëtarëve në autostradat në Evropë, por edhe në rajon, tashmë është një rregull i zakonshëm.

Vënia e taksave për shfrytëzimin e autostradave në të kaluarën ishte thënë se do të bëhet për arsye të menaxhimit dhe mirëmbajtjes nga sektori privat për shkak të kostove të papërballueshme për buxhetin e shtetit. Por, tetë vjet nga lëshimi në qarkullim i autostradës që lidh Kosovën me Shqipërinë dhe dy vjet nga përfundimi i autostradës që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut, në to qarkullohet pa pagesë.

Lidhur me procesin e dhënies me koncesion të autostradave, Qeveria e Kosovës ende nuk ka bërë të ditur për publikun ndonjë plan të detajuar. "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për të marrë informacione lidhur me këtë temë, por nga ky institucion nuk kanë kthyer përgjigje.

Po ashtu, edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk u është përgjigjur pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" lidhur me këtë çështje.

Eksperti i komunikacionit, Nol Dedaj, profesor në Kolegjin UBT, thotë se kriteret teknike të autostradave në Kosovë nuk janë plotësuar dhe nuk mund të bëhet përcaktimi i pagesës për autostradë. "Autostradat tona ende nuk janë të pranuara teknikisht, nuk i plotësojnë të gjitha kriteret, pasi që iu mungojnë pushimoret. Nuk mund të bëhet një pagesë, për shembull 3 euro, derisa drejtuesi i automjetit nuk ka ku të ndalet të pushojë për nevoja të veta. Këto janë elementet teknike që ne i përkufizojmë tek autostradat. Këto janë detaje dhe kritere që nuk janë plotësuar", ka thënë Dedaj.

Që nga paslufta e deri në vitin 2020 janë bërë investime kapitale në ndërtimin e rrugëve në Kosovë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vend janë 137 kilometra autostradë.

Autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë, e quajtur "Ibrahim Rugova", ka kushtuar mbi 700 milionë euro. Ndërkaq, autostrada Prishtinë - Shkup, e quajtur "Arbën Xhaferi", me gjatësi prej 55 kilometrash, i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 600 milionë euro.

Të gjitha vendet e rajonit kanë një taksë specifike për autostradat, taksë e cila shërben për mirëmbajtjen e rrugës. Kjo taksë ndryshon nga shteti në shtet.

Sipas faqes zyrtare tolls.eu, e cila tregon të gjitha çmimet që duhet të paguhen në çdo autostradë në vendet e rajonit dhe me gjerë, çmimet e taksës për autostradë, përcaktohen sipas lartësisë së automjetit.

Në Shqipëri, në autostradën, Milot - Morinë, që njihet si "Rruga e Kombit", e që ka gjatësi prej 128 kilometrash, pagesa për motoçikleta është 2.50 euro, ndërsa për vetura 5 euro. Autostrada Beograd - Preshevë, me gjatësi 350 kilometra, për motoçikleta kushton 6.2 euro, ndërsa për vetura, taksa është 12.4 euro.

Për autostradat në Maqedoninë e Veriut, çmimet fillojnë nga 1.3 euro deri në 4.36 euro, varësisht nga kilometrat e autostradës.

Ish-ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, i cili drejtoi këtë ministri më 2018-2019, në qeverinë e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, thotë për Radion Evropa e Lirë se kishin nisur ta bënin një studim të fizibilitetit, por që kishte mbetur në gjysmë.

Autostradat, thotë ai, kishin menduar t'i bënin me pagesë, pasi që ato duhet të mirëmbahen. "Çdo shtet që pretendon që të ketë një zhvillim ekonomik apo zhvillim të korridoreve duhet të investojë në infrastrukturë. Por, ajo që vlen të theksohet është që infrastruktura duhet të mirëmbahet. Unë kam menduar që autostradat të bëhen me pagesë, por pas dorëheqjes së qeverisë Haradinaj, ky proces ka ngecur", ka thënë Lekaj.

Infrastruktura rrugore kryesisht ka mbizotëruar investimet në Kosovë vitet e fundit. Përveç autostradave, investime të mëdha janë përqendruar edhe në ndërtimin e rrugëve lokale dhe magjistrale.

Përqindja më e madhe e buxhetit të Kosovës zakonisht ishte ndarë pikërisht për ndërtimin e autostradave.

Kosova ka një infrastrukturë të mirë rrugore. Sipas të dhënave të Ministrisë së Infrastrukturës të vitit 2020, nga gjithsej 2 378.7 kilometra rrugë, 2 210.7 kilometra apo 96.6 për qind janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 81 kilometra apo 3.4 për qind e rrugëve janë të paasfaltuara.



# Hëna Abdullahi, violinistja e talentuar që synon skenat botërore



Lulëzim ETEMAJ

Hëna Abdullahi, 15-vjeçare, nga Tetova. Ky emër duhet të shënohet dhe përcillet vëmendshëm si nga profesionistët e artit muzikor ashtu dhe përcjellësit e tij. Ajo tashmë me lojën e shkëlqyeshme me violinë ia ka arritur të bindë juri të shumta profesionale. Vlerësimi me nota të larta, që ato u kanë bërë interpretimeve të Hënës, e kanë renditur atë lart, përfshirë edhe vendin e parë, qoftë në gara të karakterit vendorë, qoftë në ato ndërkombëtare.

Hëna Abdullahi violinën filloi ta mësojë që nga mosha gjashtëvjeçare. "Është nxënëse shembullore, e sjellshme, e edukuar mirë por, mbi të gjitha, është nxënëse punëtore e cila kërkon shumë nga vetja dhe pikërisht kjo e fundit e bën atë që të arrijë suksese në drejtimin profesional".

Kështu e vlerëson Hënën profesori i violinës, i cili ka rol kyç në suksesin e saj, Shkelzen Pajaziti.

Viti 2014: Gara shtetërore - çmimi i tretë; 2015: Gara shtetërore - çmimi i dytë; Gara ndërkombëtare në Serbi - çmimi i tretë; Gara ndërkombëtare "Sergej Mihajlov" - çmimi i parë, 12 maj 2021; Festivali ndërkombëtar "Polyhymnia" (Shkup) - çmimi i parë, më 11 maj 2021.

Këto janë çmimet shtetërore dhe ndërkombëtare që i ka fituar deri më tani violinistja e talentuar Hëna Abdullahi.

Ëndrrat dhe synimet e Hënës në fushën e profesionit shkojnë larg përtej këtyre çmimeve. "Të bëhem violiniste e suksesshme dhe të arrij të interpretoj në skenat e mëdha botërore", kështu përgjigjet ajo në pyetjen e parashtruar rreth së ardhmes së saj profesionale në skenën muzikore. Ndërsa sukseset e arritura deri tani, Hëna thotë se ia dedikon familjes dhe profesorëve të saj.







Krahas marrjes pjesë në gara dhe koncerte të ndryshme, Hëna ka mbajtur në qershor të vitit 2019 në Tetovë koncertin e parë recital. Momentalisht ajo është duke u përgatitur për koncertin e dytë recital që pritet të mbahet në qershor të këtij viti po në Tetovë.

Suksese në rrugëtimin e Hëna Abdullahit drejt majave të muzikës botërore pret edhe profesori i saj Shkelzen Pajaziti. "Unë si mësimdhënës i saj pres që ajo të arrijë majat më të larta të suksesit në instrumentin e violinës. Jam i sigurt që nëse vazhdon të punoj me këtë ritëm, do të na bëjë të gjithëve krenarë me rrugëtimin e saj", shprehet profesor Pajaziti.

# Tahiri kërkon nga qeveria të mobilizohet kundër dhunës seksuale

**Prishtinë, 16 maj (ER)** - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka kërkuar nga qeveria të mobilizohet sa i përket shqyrtimit të fenomeneve të rrahjes, bullizmit, abuzimeve seksuale dhe psikologjike në shkolla. Ky reagim i tij ka ardhur pas dyshimeve për abuzim seksual të një të miture në një shkollë të Prishtinës. "Trekëndëshi, shkollë (institucione) - nxënës - prind është dobësuar, duke sjell probleme zinxhirore për secilin prej këtyre palëve. Mungesa e fokusit në problemet sociale (shoqërore) po na shpërfaq dukuri të pazakonta e të rrezikshme për shoqërinë. Raste si këto nuk mund të trajtohen, veçmas nga ambienti i përgjithshëm social, reagimet në raste, nuk prodhojnë zgjidhje për sfidat që na presin si shoqëri. Shtimi i fenomeneve dhe rasteve devijante e të rrezikshme, janë të pranishme e me tendencë të përhapjes. Rrahjet, bullizmi, narkotikët, dhuna, abuzimet psikologjike dhe seksuale, po rrezikojnë të kthehen në fenomen. Kjo nuk është vetëm përgjegjësi e institucioneve, por e shoqërisë në përgjithësi. Andaj mobilizimi i qeverisë, aktorëve publikë e institucionalë, duhet të jetë urgjent e sistematik në adresimin e këtyre sfidave. Debati e fokusi, përtej konfrontimeve e diskursit të egër, duhet vendosur në problemet reale. MAShT



vepro!", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se ende s'kanë informata zyrtare, mirëpo do ta trajtojnë rastin me prioritet dhe kujdes të veçantë. "Në lidhje me shkrime dhe statuse të shumta që janë publikuar sot rreth një rasti që dyshohet të ketë ndodhur në afërsi të një shkolle në kryeqytet, edhe pse nuk kemi ende informata zyrtare, ju siguroj se do ta trajtojmë me prioritet dhe kujdes të veçantë. Besoj se njëjtë do të veprojnë të gjitha institucionet kompetente", ka thënë ministrja Nagavci.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) përmes një komunikate për media ka theksuar se ka përcjellë me shqetësim publikimin në disa media online të lajmit dhe videos për rastin e pretendimit për ngacmim seksual të një të miture në oborrin e një shkolle fillore në Prishtinë. KMShK-ja ka vlerësuar se sheh me shqetësim publikimin e fakteve rrethanore që zbulojnë lehtë identitetin e të miturve të përfshirë në rast. KMShK-ja ka bërë thirrje që të respektohet kodi i etikës në rastin e raportimit për fëmijët.

# Drejtoria e Bujqësisë në Drenas dha 40 makina mjelëse për fermerë

**Drenas, 16 maj (ER)** - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, po vazhdon mbështetjen e fermerëve të Komunës së Drenasit në sektorët e ndryshëm të bujqësisë. Nga buxheti komunal kjo drejtori ka shpërndarë makina mjelëse për të gjithë përfituesit në bazë të kritereve të caktuara të thirrjes publike, ku përfitues janë 40 fermerë.

Nënkryetari i Komunës së Drenasit, Arben Shala dhe drejtoresha për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Anita Avdullahu, kanë bërë ndarjen e këtyre pajisjeve për fermerët përfitues. Nënkryetari Shala, në emër të kryetarit Lladrovci, ka uruar të gjithë fermerët përfitues të makinave mjelëse dhe ka thënë se kjo mbështetje për fermerët është bërë për të ndihmuar ata dhe për të arritur rezultate më të mira në sasinë dhe në cilësinë e qumështit.



22 VJET NGA ZHDUKJA E VEPRIMTARIT UKSHIN HOTI

# Çështja e Ukshin Hotit dhe e të zhdukurve të tjerë të trajtohet në dialog

Më 16 maj të vitit 1999 atdhetari e mendimtari Ukshin Hoti u lirua nga Burgu i Dubravës. Që prej asaj dite asgjë nuk dihet për fatin e tij. Të dielën në 22-vjetorin e zhdukjes së Ukshin Hotit, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë thënë se Ukshin Hoti vazhdon të mbetet në listat e të pagjeturve të cilët janë rrëmbyer dhunshëm nga regjimi gjenocidal serb. Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka kërkuar që në bisedimet me palën serbe çështja e Hotit dhe e të zhdukurve të tjerë duhet të trajtohet me prioritet në tavolinën e bisedimeve



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 16 maj** - Të dielën u bënë 22 vjet qëkur, më 16 maj të vitit 1999, autoritetet e burgut të Dubravës e nxorën nga qelia intelektualin dhe politologun Ukshin Hoti i cili po mbahej padrejtësisht, me arsyetimin e lirimit dhe që nga ajo kohë nuk dihet më asgjë për fatin personal të tij. Me rastin e 22-vjetorit të zhdukjes së Ukshin Hotit, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë thënë se Serbia duhet të përgjigjet për çdo krim të kryer në Kosovë, përfshirë edhe fshehjen e informacionit për fatin e profesor Hotit. “Më 16 maj të vitit 1999 atdhetari e mendimtari Ukshin Hoti u lirua nga Burgu i Dubravës. Që prej asaj dite asgjë për fatin e tij, të përpos kujtimit të çdovitshëm dhe rëndimit të ndërgjegjes sonë për mendimtarin politik, i cili prej 22-vjetësh vazhdon të mbetet në listat e të pagjeturve, të cilët janë rrëmbyer dhunshëm nga regjimi gjenocidal serb”, ka thënë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Ajo ka thënë se fati i Ukshin Hotit është pengu i shoqërisë dhe shtetit tonë ndaj, sipas saj, përpjekja këmbëngulëse për zbardhjen e fatit të tij nuk duhet të pushojë asnjë ditë. “Me një vepër të bukur politike mund të shpëtohet një popull, thoshte Ukshin Hoti. Ai e nisi idenë e ‘veprës së bukur politike’ për lirinë, republikën dhe demokracinë, porse synimi i mendimtarit politik e filozofik mbeti në gjysmë. Republika e tij është bërë. Dy dekada në kërkim të tij, Republikës i duhet Ukshin Hoti. Çështja e zbardhjes së fatit të të pagjeturve, të cilët u zhdukën dhunshëm nga regjimi serb, është prioriteti ynë dhe parakusht për paqe të qëndrueshme në rajon”, ka thënë Osmani.

Në 22-vjetorin e zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti, të dielën në fshatin e tij të lindjes është mbajtur një tubim ku është kërkuar zbardhja e fatit të tij dhe të zhdukurve të tjerë në luftën e fundit në Kosovë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se politikanët, përfaqësuesit institucionalë, profesorët e shkencave sociale humane dhe të shkencave politike dhe juridike, duhet t’i studiojnë veprat e Ukshin Hotit. Konjufca ka propozuar që Ukshin Hoti të bëhet pjesë e korrikulumit të universiteteve dhe shkollave të Kosovës. “Ukshin Hoti nuk ka qenë një intelektual i mbyllur i zyrave. Ai ka qenë intelektual i cili e ka ndarë fatin me popullin e vet në kohët më të vështira. Ai ka kaluar nëpër të gjitha rrugët e mundshme prej viteve të shtatëdhjeta nëpër të cilat ka kaluar kombi shqiptar. Ky është patrioti i vërtetë, ky është intelektuali i vërtetë që nuk i bën bisht fatit, por i cili është pikërisht aty ku është populli i vet”, ka thënë Konjufca, duke shtuar se Ukshin Hoti gjatë burgut ka përjetuar torturat më çnjerëzore nga regjimi serb.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se 22 vjet më vonë fati i Ukshin Hotit nuk është zbardhur, kurse drejtësia për të nuk ka nisur. “Të mungosh do të thotë të jesh. Diku tjetër, larg prej njerëzve që të duan. Ukshin Hoti është edhe në veprën që ka lënë. ‘Filozofia politike e çështjes shqiptare’, ‘Bisedë përmes hekurash’ dhe ‘Lufta e Ftohtë dhe Detanti’ - tre libra, tri ditë lexim, pas të cilave nuk do të mendoni, studioni e veproni njësoj. Është më i madh se jeta”, ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ukshin Hotin e kanë përkujtuar edhe liderët opizitarë.

Kryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se po bëhen 22 vjet që presin një lajm për Ukshin Hotin. “Imazhin e fundit, shokët e tij e kujtojnë derisa Ukshini po bënte ‘hapat e lirisë’ nga burgu i Dubravës. Nga ajo ditë, asgjë. Asnjë përgjigje nga shteti serb nga e diela e 16 majit të vitit 1999 e deri në këtë të diel të vranët të vitit 2021”, ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Hoxhaj ka thënë vepra e tij edhe sot është frymëzimi ynë i përditshëm. “Kosova nuk do të jetë asnjëherë e plotë pa zbardhjen e fatit të tij”, ka shkruar Hoxhaj.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Ukshin Hoti ka formësuar mendimin politik shqiptar në dy dekadat e fundshekullit njëzet. “Frymëzoi kryengritjen të cilën e jetësoi brezi i UÇK-së. Ai promovoi etikën politike sepse politika pa etikë nuk nxit ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore, duke u bërë shembull që duhet ndjekur nga elitat politike të shqiptarëve gjithandej. Për shkak të këndvështrimit të tij të veçantë politik, ai shfaqte rrezik të përhershëm për regjimin. Ai u përndjek dhe u burgos nga organet e pushtuesit e më pas u zhduk fizikisht e ne ende nuk kemi përgjigje për fatin e tij. Por, ata kurrë nuk arritën t’i shuajnë idetë të cilat me krenari vazhdojmë t’i ndjekim. Ne asnjëherë nuk duhet të ndalemi së kërkuari drejtësi për të gjitha krimet që pushtuesi serb i kreu në vendin tonë, në respekt të veprës e sakrificës jetësore të Ukshin Hotit dhe mijëra bashkëkombësve tanë, që pësuan nga gjenocidi”, ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, në përkujtim të 22-vjetorit të zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti, ka thënë se Ukshin Hoti është pengu i lirisë tonë. Ai ka kërkuar që në bisedimet me palën serbe çështja e Hotit dhe e të zhdukurve të tjerë duhet të trajtohet me prioritet në tavolinën e bisedimeve.

Latifi ka thënë se pushteti lokal në Rahovec i ka kryer disa nga obligimet që ka ndaj kësaj figure të madhe kombëtare, duke e ndërtuar shtëpinë-muze të Ukshin Hotit, ndërsa ka bërë me dije se në vazhdim po punohet për ngritjen e kompleksit historik e kulturor “Ukshin Hoti”. “Autoritetet shtetërore dhe arsimore e kanë për detyrë ta trajtojnë këtë figurë kombëtare në përputhje me përmasën e tij, duke e futur në programet mësimore dhe në tekstet shkollore. Mësimet dhe pikëpamjet e tij për çështjen e pazgjidhur shqiptare vazhdojnë të jenë avangarde, prandaj mendimi i tij politik shkencor përbën thelbin e problemeve tona që kërkojnë zgjidhje në të ardhmen”, ka thënë kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi.

## Të zhvillohen hetime të hollësishme për ta ndriçuar fatin e Ukshin Hotit

Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka kërkuar që të zhvillohen hetime të hollësishme për ta ndriçuar fatin e Ukshin Hotit. “Sot u bënë 22 vjet qëkur intelektuali i shquar Ukshin Hoti u liria nga burgu në të cilin po mbahej padrejtësisht nga shteti serb. Më 16 maj 1999 Ukshin Hotit i skadon dënimi dhe ai nxirret jashtë burgut ndonëse ishte një ditë e diel, gjë që nuk ishte e zakonshme për burgjet e atëhershme. Ai u shoqërua nga dy roje të burgut drejt daljes dhe nga ai moment nuk dihet asgjë për fatin e tij. Përgjegjësia për zhdukjen e tij bie mbi shtetin serb i cili ato ditë ishte duke zbatuar planin e gjenocidit kundër shqiptarëve. Tri ditë më vonë shumë të burgosur të tjerë do ta gjenin vdekjen. Pas bombardimit të burgut nga aviacioni ushtarak, forcat serbe qëlluan mbi të burgosurit dhe bënë një nga masakrat më të tmerrshme në Kosovë, duke vrarë mbi njëqind të burgosur shqiptarë e plagosur qindra të tjerë”, është thënë në komunikatën e kësaj qendre.

Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka theksuar se as sot e kësaj dite nuk është marrë në përgjegjësi asnjë pjesëtar i forcave serbe për zhdukjen e Ukshin Hotit, ndonëse dihen me emra e mbiemra të gjithë ata që kanë shërbyer në burgun e Dubravës. “Qendra ‘Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” kërkon që Prokuroria e Kosovës të zhvillojë hetime të hollësishme për ta ndriçuar fatin e Ukshin Hotit dhe përgjegjësit për zhdukjen e tij të sillen para drejtësisë”, është thënë në komunikatën e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”.



# Ulqini në këtë sezon ofron ulje çmimesh dhe shmangie të pritjeve kufitare

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Ulqin, 16 maj - Qyteti i Ulqinit prej dekadash mbetet destinacioni turistik për qytetarët e Kosovës dhe të rajonit e të botës në përgjithësi.
Ulqini është qytet i njohur me një numër të shumtë të plazheve që shtrihen në një sipërfaqe bregdetare prej 25 kilometrash. Shumë plazhe janë gurore, por Ulqini njihet me dy plazhet e veta ranore: plazhin e vogël dhe plazhin e madh.
Ulqini ofron për vizitorët tipa të ndryshme hotelesh dhe apartamentesh, nga me modernët deri tek apartamentet antike.
Vizitorët e kanë mundësinë që të bëjnë rezervime edhe me anë të internetit, agjencive turistike ose drejtpërdrejt me hotelet.
Buzë plazhit të vogël është edhe Kalaja e Ulqinit që është ndër vendet më arkitektonike në Ballkan, duke pasur kështu frekuentim të vazhdueshëm nga gjithsecili që viziton Ulqinin. Gjithashtu, Ulqini ofron edhe shtigje të shumta për vrapim.
Jeta e natës në Ulqin frekuentohet shumë, sidomos gjatë sezonit turistik. Lokalet e natës ofrojnë muzikë të zgjedhur me Dj profesionistë, gjithashtu edhe muzikë live e cila pëlqehet shumë nga të gjithë turistët pa dallim moshe.
Ulqini me të vërtetë është qytet me kultura të ndryshme, ku mund të kaloni një kohë të mirë, të relaksoheni dhe të përjetoni shumë gjëra të bukura.
Mbi të gjitha, në qytetin e Ulqinit turistët do të gjejnë siguri në nivelin më të lartë.

### Pandemia e preku edhe Ulqinin

Si çdo sektor tjetër, edhe turizmi në Ulqin u prek nga



pandemia Covid-19. Sipas kryetarit të Komunës së Ulqinit, Gzim Hajdinaga, i cili mban edhe pozitën e drejtorit të Organizatës Turistike në Ulqin, tani është prioritet i autoriteteve në këtë komunë ringjallja e turizmit. Ai ka thënë se në këtë sezon do të ketë ulje çmimesh dhe siguri maksimale për turistët që vizitojnë Ulqinin. "Këtë sezon do të ketë ulje çmimesh. Këtu prindi nuk ka nevojë që të shqetësohet për sigurinë e fëmijëve. Siguria në Ulqin është në nivelin e duhur. Pastërtia po ashtu. Andaj mirëpresim turistët në këtë sezon. Gjithashtu këtë vit nuk do të ketë radhë të gjata në kufi, sepse do të hiqet polisa kufitare. Pos kursimit të mjeteve monetare, qytetarët e Kosovës do të kenë kursim edhe në kohën e tyre nga shmangia e pritjeve të gjata në kufi", ka thënë Hajdinaga.

Për çmimet konkurruese dhe heqjen e polisave kufitare ka folur edhe kryetari i Komunës së Ulqinit, Aleksandër Daboviç. Ai ka thënë se në këtë sezon janë bërë gati për pritjen e turistëve nga Kosova. "Në bashkëpunim me autoritetet qeveritare dhe ministritë përkatëse kanë punuar që në kufirin në Muriqan mos të paguhet më polisa kufitare, por të krijohen lehtësira që hyrje-daljet të jenë sa më të shpejta dhe të shmangen radhët e gjata", ka thënë ai, duke shtuar se Ulqini do të ofrojë çmime të arsyeshme për turistët.

Në qytetin e Ulqinit ofrohen plazhet si ato me rërë të cilat kanë veti të shumta shëruese, ashtu dhe ato shkëmbore të cilat janë zakonisht preferencë e moshës rinore dhe moshës së mesme.

Në Ulqin është edhe plazhi i grave, ku uji sulfurik i këtij plazhi dhe rëra ofrojnë një sërë veti shëruese. Zana Zarvan, menaxhere për brendim në Organizatën Turistike në Ulqin, ka bërë një përshkrim të vetive shëruese të cilat i ka plazhi i grave në Ulqin. "Plazhi i grave ka veti shëruese. Quhet plazhi i grave sepse është ekskluzivisht për zonjat. Të gjitha zonjat që kanë probleme të ndryshme



në aspektin e lindjes vijnë dhe zhytën në ujin sulfurik dhe kemi rezultate pozitive", ka treguar ajo.

Ndërkaq Jerola Zija nga 'Trip to Albania' ka folur për turizmin në viset shqiptare, atë dimëror dhe malor. "Meqenëse jemi në sezonin bregdetar, mund të themi se Ulqini është vend që ia vlen të vizitohet si për nga kushtet bregdetare që ofron ashtu edhe për nga çmimet. Më pastaj ne do të fokusohemi edhe në Kosovë dhe pjesë të tjera të Shqipërisë dhe do të bëhemi gati për ta promovuar turizmin malor, por edhe segmentet e tjera", ka thënë Zija.




Plazhi i "CaboBeach" është i njohur edhe si plazhi i "kosovarëve".

Në sezonin e kaluar ky plazh pati rënie drastike të pushuesve.

Arti Rexha, pronar i 'CaboBeach', ka thënë se pandemia u ka shkaktuar humbje të mëdha. "Kemi pasur rënie të humbjes rreth 75 për qind. Ne kemi rreth 500 çadra, shumica janë pushues nga Kosova. 'CaboBeach' është unik dhe ofron çmime të arsyeshme", është shprehur ai.

Lumi Buna mbetet një tjetër bukuri natyrore që ndodhet në segmentin fundor jugperëndimor të kufirit shqiptaro-malazez.

Pak kilometra larg Ulqinit, buzë këtij liqeni, pos peizazheve magjepse që ka ditur vetëm Zoti të krijojë, do ta gjeni edhe restorantin me ushqime bregdetare. Po ashtu, për të mësuar se si ka jetuar prej dekadash nga ullinjtë në periferi të Ulqinit do ta gjeni edhe fushën e ullinjve.

Fatmir Sadiku, prodhues i vajit të ullirit, ka bërë një kronologji të fushës së ullinjve dhe mijëvjeçareve të ekzistencës së tyre. "Kemi ullinj një mijë deri në dy mijë vjeçar. Natyra këtu është e mbrojtur dhe nuk lejohen investime, pasi kjo natyrë është e lidhur me kulturën dhe historinë tonë. Ulqini me shekuj ka jetuar vetëm nga ullinjtë", ka thënë Sadiku.

# Dogana për katër muaj mblodhi rreth 400 milionë euro, shpejt nis zhdoganimi i mallrave në Durrës

**Prishtinë, 16 maj** - Dogana e Kosovës para dy vjetëve zyrtarisht kishte hapur zyrën e saj në Portin e Durrësit, marrëveshje kjo në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për ta lehtësuar tregtinë, lëvizjen e shpejtë të mallrave dhe të pasagjerëve.

Zyrtarë të Doganës së Kosovës thonë se nga kjo pikë doganore shfrytëzohet mjaft nga bizneset e Kosovës dhe përfitimet e tyre janë të shumta për dërgesat që i bëjnë në drejtim të Kosovës.

Në Doganë, po ashtu, tregojnë se në katërmujorin e parë të këtij viti të hyrat totale janë 396.4 milionë euro ose 25 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Për zyrën e doganës në Durrës zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, pret që shumë shpejt të nisë edhe zhdoganimi i mallrave në bregdetin shqiptar ndonëse, sipas tij, kjo mbetet në vullnetin e dy qeverive, asaj të Shqipërisë dhe të Kosovës. "Ende nuk kemi filluar me zhdoganim për shkak se ka procedura të ndryshme financiare të cilat bëhen në rastin e pagesave. Besojmë se shumë shpejt do të arrihet edhe kjo në mënyrë që të kemi një procedurë komplete të zhdoganimit. Jo pse tani nuk është procedurë komplete, sepse e njëjta procedurë e transitit zhvillohet edhe në pikat




kufitare si, p. sh., në Han të Elezit. Këto janë çështje të cilat iu përkasin institucioneve të larta, kurse Dogana është në aspektin e zbatimit të tyre", ka thënë Stavileci.

Ai ka theksuar se që nga hapja e pikës kufitare në Durrës, qeveritë e dy vendeve kanë mundësuar krijimin e një hallke me anë të kësaj pike doganore, e cila ka eliminuar vonesa në dërgesat e mallrave që targetohen në portin e Durrësit dhe janë të adresuara për Kosovë.

Stavileci ka theksuar se shumë biznese janë duke e shfrytëzuar këtë pikë. "Tani kompanitë nga Kosova mund t'i sjellin mallrat e tyre në Durrës, ato trajtohen dhe marrin trajtim doganimi nga Dogana e Kosovës si transit dhe pastaj vazhdojnë në terminalin e brendshëm doganor në Kosovë. Pra, hallka e Doganës së Shqipërisë, kontrolli dhe transiti përmes Doganës së Shqipërisë, kjo është eliminuar dhe është zhvendosur direkt te Dogana e Kosovës", ka thënë Stavileci. (kp)

# Strategjia e shërbimit sekret serb për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së pas vitit 2000 e këndej (4)



Faton B. MEHMETAJ

Këtë luftë të ndyrë të shërbimit sekret serb duke përpiluar dosje të rreme e të kamufluara kundër UÇK-së më së miri e tregon rasti i arrestimit të tre serbëve nga Policia e Kosovës më 11 qershor të vitit 2009 në fshatin Çagllavicë (në jug të Prishtinës): Igor Juçinacit (1972) shtetas i Kosovës, Millutin Radanoviqit (1957) shtetas i Serbisë dhe të Predrag Zhelkoviqit (1976), shtetas i Serbisë, nënë dyshimin se kanë paguar njerëz në shuma deri në 100.000 euro, për të ofruar dëshmi të rrejshme kundër UÇK-së. Këta tre persona ishin pjesëtarë të Agjencisë Serbe të Inteligjencës (Bezbednosno Informativna Agencia), të cilët u kanë premtuar edhe të mira materiale njerëzve të nacionalitetit serb edhe shqiptar, si banesa, vende pune e pare kesh etj., që të deklarojnë rrejshëm se ata ose të afërmit e tyre kanë qenë viktimë të transplantimit të organeve njerëzore nga UÇK-ja gjatë luftës në Kosovë 1998-99. Akuzat e njëjta për transplant të organeve njerëzore të serbëve nga UÇK-ja i ka bërë kryepokurorja e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për krimet e luftës në ish-Jugosllavi, në librin e saj "Gjuetia: Unë dhe kriminelët e luftës" të botuar në vitin 2008, të cilën e kam përmendur edhe më lartë. Në gjithë këtë histori një rol negativ e ka luajtur edhe administrate e UNMIK-ut, të cilët e kanë goditur elementin e UÇK-së në mënyrë sistematike të koordinuar edhe me shërbimet sekrete serbe, ushtarake dhe të inteligjencës. Në këtë fushatë të planifikuar, pati edhe zyrtarë të lartë që e mbajtën hapur anën e Serbisë, por edhe të klaneve mafioze duke i stimuluar edhe grupacionet e njerëzve anti UÇK, kundër strukturës së UÇK-së. Ndër ta ishte edhe Valerij Corotekno, ish-komandanti ndërkombëtar i policisë së UNMIK-ut, për rajonin e Dukagjinit me seli në Pejë, ishte i lidhur më rrjetin e "Klanit të Zemunit", të cilët operonin në Kosovë, nëpërmjet kolegëve të tyre shqipfolës, Corotekno e kishte shndërruar Pejën në arenë luftimesh mes grupeve. Ai fitoj shuma të mëdha parash nga kartela e drogës dhe naftës. Kjo klasë e infektuar nga virusi i injorancës në mënyrë sistematike dhe krejtësisht të planifikuar e shembën autoritetin e njerëzve më ndikim, figurave të mëdha dhe simboleve të Kosovës. Kështu ndodhi edhe me Gjykatën Speciale e cila u formua me qëllim të gjykimit të njerëzve në mënyrë të paanshme, por pasi e arritën qëllimin doli krejt diçka tjetër, gjykatë selektive, njënacionale dhe vetëm kundër pjesëtarëve të UÇK-së. E gjithë kjo u bë për ti trajtuar e gjykuar, krimet e supozuara dhe të sajuara nga klanet e caktuara të shoqërisë sonë të cilat për 20 vite rresht u përdorën nga këto shtresa të shoqërisë për revanshe politike se sa për ta zbuluar të vërtetën. Ata ishin edhe paditës edhe gjykatës. Nga të njëjtat shtresa u përhapë psikoza e frikës nga UÇK-ja në Kosovën e lirë, kjo situatë u arrit nga njerëzit e ndihmuar prej shërbimit të fshehtë serb. Bije fjala kujt i duhen imazhet e rrejshme të Kosovës, askujt përveç armiqve. Të gjitha faktet e të dhënat tregojnë se i gjithë ky skenar ishte një komplot mirë i organizuar nga eprorët e KOS-it, UDB-së, BIA-s e shërbimeve tjera të lidhura me shërbimet ruse e të miqve të Serbisë për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së. Gjerë më tani nga viti 2000 e gjerë në vitin 2021, janë hetuar vetëm struktura e UÇK-së, për të gjithë të tjerët është heshtur, edhe nga UNMIK-u, EULEX-i, drejtësia vendore, BE-ja e mekanizmat tjerë vendor e ndërkombëtar. Asnjë fjalë e vetme nuk u tha për bashkëpunëtorët e shërbimit sekret, për sabotazhet e tyre kundër Kosovës, për bojkotimet e të këqijat tjera që ndodhën në Kosovë e që lidhen me këtë shtresë. Shumë atentate të kryera ndaj shqiptarëve në shtetet e ndryshme të Evropës dhe më gjerë por edhe në Kosovë nga vitet '90-ta e deri në mbarim të luftës, duke e përfshirë këtu edhe periudhën e pas vitit 2000, këto vrasje kanë një lloji lidhshmërie me vrasjet që i kanë kryer njësitë special dhe paramilitare serbe, para luftës së fundit, gjatë dhe pas mbarimit të saj. Sa për ilustrim po e përmendi vrasjen politike të Enver Hadrit (1941- 25 shkurt 1990), i cili u vra me 25 shkurt 1990, në moshën 49 vjeçare, nga shërbimi sekret serb për shkak të veprimtarisë politike të tij. Ishte veprimtar për të drejtat njerëzore dhe politike të shqiptarëve të Kosovës. Në fillim të vitit 1972 ai u vendos në Bruksel, ku vazhdoi veprimtarinë politike nëpërmjet Organizatës Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës. Këtë vrasje e kishte organizuar shërbimi sekret serb i kohës për ta ndalur aktivitetin politik të tij. Vrasja e Enver Hadrit është tipike, vrasje politike. Shërbimi sekret serb për ta vrarë Enver Hadrin i kishte angazhuar njësinë e atentatorëve që i kishin trajnuar si pjesë të shërbimit sekret për likuidimin e kundërshtarëve politik të Serbisë. Atentatorët që morën pjesë në vrasjen e Enver Hadrit ishin: Veselin Vukotiq (Veshko), Andria Lakoniq, dhe Darko Ashanin, të cilët e qëlluan me dy plumba në kokë deri sa kishte ndaluar ne një semafor. Madje Vukotiç, përpos vrasjes së Enver Hadrit ai kishte edhe dokumente paditëse për kryerjen disa vrasjeve tjera në ish-Jugosllavi të urdhëruara nga Sllobodan Milloshevin dhe shërbimi sekret i tij. Për këto vrasje pati edhe dëshmitar për të konfirmuar dëshmitë e tyre që kishin dhënë me parë në Tribunalin e Hagës. Ditën kur u vra Enver Hadri, e kishte me vete listën e 32 shqiptarëve të vrarë në Kosovë nga Serbia të cilën do t'ia dorëzonte të nesërmen Komisionit të të Drejtave të Njeriut të Parlamentit Evropian. Për ti zhdukur gjurmët e kësaj vrasje, shërbimi sekret serb organizoj likuidimin e Andrija Llakoniq dhe Darko Ashanin, në Serbi të cilët ishin pjesëmarrës në këtë vrasje. E përmenda këtë rast për të treguar se gjyqi për zbardhjen e vrasjes së Enver Hadrit ka zgjatur nga viti 1990 deri më 22 nëntor 2016 kur Gjykata Penale e Brukselit, në përbërje të tre gjyqtarëve profesionistë dhe të jurisë prej 12 qytetarëve të zgjedhur me short mbajti 12 seanca gjyqësore ku u shqyrtua aktakuza e Prokurorit të Mbretit e cila ngarkon Veselin Vesko Vukitiqin, Andrija Drashkoviqin (kriminelë të njohur nga nëntoka serbe) dhe Bozhidar Spasiqin (shef për operacione speciale i UDB-së jugosllave) për vrasjen me paramendim të Enver Hadrit, kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë. Vrasësit serbë të ish-aktivistit Enver Hadri, janë shpallur fajtorë nga Gjykata Penale e Brukselit në Belgjikë. Ky rast tregon dhe inkurajon secilin se nuk duhet heshtur për vrasje politike deri sa të zbardhet e vërteta, por as nuk duhet të marrin ngjyrime politike për llogari të askujt. Sipas disa të dhënave të autoriteteve gjermane, Shërbimi sekret jugosllav për një kohë të caktuar ndoshta 10 vjeçare, kishte vrarë rreth 70 emigrantë në disa vende perëndimore. Së paku 13 raste të këtij kapitulli të përgjakshëm nuk janë mbyllur ende nga drejtësia gjermane. Gjatë luftës në Kosovë përgjegjësit e Grupit Operativ "Operativna Grupa" (OPG), që njëkohësisht ishin edhe pjesëtarë të policisë elite serbe, gjatë operacioneve të kryera nuk linin gjurmë. Pos që morën pjesë në një varg krimesh në Kosovë, këta i vazhduan aktivitetet e tyre kriminale edhe pas luftës në formë të organizuar, duke i kryer shumë vrasje me prapavijë politike për llogari të shërbimit sekret serb. Drejtuesit e OPG-së i kishin marrë urdhrat nga gjeneral të lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Një dëshmitar i mbrojtur në Hagë, kolonel serb, në gjykimin e Milloshevigit pati deklaruar: Kemi pasur njësitë special të kamufluara me uniforma të UÇK-së, që kanë komunikuar shqip, dhe që kanë vrarë, dhunuar, plaçkitur dhe djegur, jo vetëm civil shqiptarë, por edhe serbë". Në pyetjen pse? Ai është përgjigjur: "Kemi zbatuar dy urdhra nga lartë: Të vrisnim civilë dhe ta komprometonin luftën e UÇK-së". Me veprimtari të ngjashme është marrë edhe grupi paramilitar "Munja" (Vetëtima), i përbërë prej strukturave të policisë serbe, prej kriminelëve të verifikuar, dhe grupit të vetëquajturve patriot. Ky grup merrte urdhra dhe zbatonte urdhra të eprorëve të policisë dhe të armatës. Serbët i konsideronin si legjionar, veçanërisht për sulmet e pamëshirshme që i bënin mbi civilët shqiptar. Udhëheqës i këtij grupi ishte krimineli famëkeq Vlladimir Shalipuri i cili u vra nga Avni Elezaj epror i Brigadës 131 "Adrian Krasniqi". Pas mbarimit të luftës Avni Elezi pjesëtar i UÇK-së dhe TMK-së, u vra nga mbështetësit e grupit "Munja" me 12 tetor 2002, në afërsi të restorantit "Peja City" në shenj hakmarrje për vrasjen e Shalipurit, bashkë më Bekim Mustafën (1975) nga Klina e Poshtme e Skenderajt me banim në Arbëresh (ish-Vitomiricë) të Pejës, po ashtu pjesëtar i UÇK-së. Disa kohë pasi u vra Avni Elezaj persona edhe sot të panjohur ja vranë edhe babanë. Në kësi rrethanash u vra Besim Mala (Komandant "Murrizi"). Për vrasjen e tij ka indice se e kishte organizuar shërbimi sekret serb. Vetëm disa ditë para se të vritej në atentat, UNMIK-u, pa kurrfarë shkasi apo arsyetimi, ia kishte marrë lejen e armëmbajtjes dhe armën me leje që e posedonte. Oponentët e "Klanit të Zemunit" dhe të organizatave tjera ekstreme serbe të cilat monitoroheshin nga shërbimi sekret serb e që vepronin edhe në Kosovë, u përkrahën edhe nga strukturat e UNMIK-ut.



(Vijon)


Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.
5.99€
ISBN 978-9951-780-56-8
Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE
Mehmet Kraja
HËNA PREJ LETRE
(Drama, trilogji)
ARMAGEDONI


FATMIR LEKAJ
KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET
E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI
një qasje teoriko-interpretuese
ARMAGEDONI
Fatmir Lekaj (1971) lindi në Pejë. Që tridhjetë vjet jeton në Norvegji. Fillimisht ka studiuar për të drejtat e njeriut dhe për trajtimin e konflikteve, ndërkohë edhe për shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslos, kurse për studime postmagjistraturale është përqendruar në temat që kanë të bëjnë me nacionalizmin, multikulturalizmin dhe integrimin. Merret me veprimtari të kërkuesit të pavarur dhe të këshillëdhënies për çështjet e integrimit etj. Është përkthyes i kualifikuar norvegjisht-shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Norvegji.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Prishtina shpallet kampione e Superligës

**Pas tetë vjetësh, Prishtina ia ka arritur ta rikthejë në kryeqytet titullin e kampiones. Ky trofe do t'i japë mundësi skuadrës më të madhe në vend që të marrë pjesë në garat parakualifikuese të Ligës së Kampionëve**

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 MAJ - FC Prishtina është shpallur kampione e Superligës për edicionin 2020/2021, një xhiro pa përfunduar kampionati i rregullt. Kryeqytetasve iu mjaftonte vetëm një pikë në dy ndeshjet e fundit për ta rikthyer titullin pas tetë vjetësh, por arritën ta mposhtin Gjilanin (1-2) dhe ndeshjen e fundit kundër Ballkanit do ta luajnë vetëm për prestigj.

Prishtina dy golat i shënoi në pjesën e parë të ndeshjes nëpërmjet Gledi Micit nga penalltia dhe Qëndrim Zybës. Gjilani e ngushtoi epërsinë në 1-2 me golin e realizuar nga Arbër Çyrbja. Prishtina ka grumbulluar 78 pikë, kurse Gjilani është në vendin e katërt me 48 pikë. "Çdo titull ka shijen e vet, por mungesa prej tetë vjetësh e bën këtë titull edhe më të veçantë. Ky titull i ka munguar shumë vite ekipit tonë dhe më së shumti i kemi gëzuar qytetarët e Prishtinës dhe 'Plisat'. Këtë titull ua dedikojmë 'Plisave' të cilët na kanë qëndruar afër gjithmonë. Për të ardhur deri te kjo ndeshje kemi kaluar shumë sfida. Momenti kyç pas humbjes ndaj Drenicës ku morëm mbështetje maksimale pasi ishte vështirë pasi krijuam rezultate negative dhe shumë stres, mirëpo besimi i tyre u shpërblye me titull kampion", ka thënë Zekirija Ramadani, trajner i Prishtinës.



Fitore ka shënuar edhe skuadra e Dritës në përballje me Drenicën (0-3). Golat për ish-kampionët i shënuan Ardian Limani në pjesën e parë të ndeshjes, kurse në pjesën e dytë realizues ishin edhe Xhevdet Shabani dhe Festim Alidema. Drita është afër që të përfundojë e dyta në tabelë dhe ta sigurojë pjesëmarrjen në garat evropiane, derisa Drenica me gjasë do të bëjë gara edhe në edicionin tjetër në elitë. Fitore ka shënuar edhe Ballkani në përballje me Trepçën '89 (4-3). Golat për suharekasit i shënuan Arbër Hoxha dy herë, kurse nga një e shtuan Ermal Krasniqi dhe Mirlind Daku. Për mysafirët shënues ishin Muja, Shala dhe Jashari. Ballkani vazhdon të jetë në garë për pozitën e dytë, kurse Trepça '89 do ta kërkojë sigurimin e mbijetesës në xhiron e fundit, pasi zë vendin e nëntë me 39 pikë.

Fitore të rëndësishme në garën për mbijetesës ka arritur arriti Arbëria në përballje me Llapin (3-2), pas tri pikëve skuadra e Arbërisë zë vendin e tetë me 40 pikë. Dy gola për vendasit i realizoi Marclei Santos dhe një tjetër e shtoi Almir Kryeziu, kurse për mysafirët shënuan Kastriot Selmani dhe Muhamet Hyseni. Llapi renditet në pozitën e pestë me 42 pikë. Fitore të rëndësishme për garë për mbijetesë arriti edhe Feronikeli në përballje me Besën e Pejës (3-1). Tash "Nikli" zë vendin e shtatë me 41 pikë, kurse Besa është e fundit me vetëm 12 pikë.

**SUPERLIGA - Java 35**

| | |
|---|---|
| Gjilani - Prishtina | 1-2 |
| Drenica - Drita | 0-3 |
| Ballkani - Trepça '89 | 4-3 |
| Arbëria - Llapi | 3-2 |
| Feronikeli - Besa | 3-1 |

**Tabela**

| | | Pikë |
|---|---|---|
| 1. Prishtina | 35 | 78 |
| 2. Drita | 35 | 73 |
| 3. Ballkani | 35 | 71 |
| 4. Gjilani | 35 | 48 |
| 5. Llapi | 35 | 42 |
| 6. Drenica | 35 | 42 |
| 7. Feronikeli | 35 | 41 |
| 8. Arbëria | 35 | 40 |
| 9. Trepça '89 | 35 | 39 |
| 10. Besa | 35 | 12 |

**Në xhiron e fundit takohen: Prishtina-Ballkani, Drita-Arbëria, Llapi-Feronikeli, Trepça '89-Drenica, Besa-Gjilani.**

# Nuhiu tërhiqet nga Përfaqësuesja e Kosovës

PRISHTINË, 16 MAJ - Sulmuesi Atdhe Nuhiu edhe zyrtarisht është larguar nga Përfaqësuesja e Kosovës në futboll. Lajmin e ka konfirmuar vetë sulmuesi shtatlartë nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Instagram". "Sot kam marrë vendimin më të vështirë në karrierën time si profesionist në futboll. Kam vendosur të ndaj me ju lajmin e tërheqjes sime nga Kombëtarja e Republikës së Kosovës, një ekipi me të cilin kam kujtime të jashtëzakonshme dhe çaste të paharrueshme gjatë rrugëtimit katërvjeçar", ka shkruar Nuhiu. "Më kujtohet takimi i parë me udhëheqësit e Përfaqësueses së Kosovës kur pranova me krenari të luaj për këtë përfaqësuese. Gjithmonë do të jem




falënderues për kryesinë e përfaqësueses, të gjithë bashkëlojtarët, kryetarin Agim Ademi, nga i cili kishim mbështetjen maksimale edhe në kushtet më të vështira, ish-trajnerin Albert Bunjaku me të cilin bashkëpunova nga dita e parë në përfaqësuese dhe qëllimin e vetëm e kishim të punojmë në mënyrë sa më profesionale e të ndërtojmë një ekip apo një përfaqësuese që e ëndërruan shumë gjenerata para nesh", ka shtuar Nuhiu.

Sulmuesi shtatlartë është optimist se Kosova me të ardhmen mund të ketë suksese në arenën ndërkombëtare pasi ka një ekip të mirë. "Sot Përfaqësuesja e Kosovës ka një super ekip dhe shpresë për lavdi e suksese në arenë ndërkombëtare, madje duke dëshmuar se mund të konkurrojmë me kombëtare si Anglia, Spanja etj. Dua t'i falënderoj të gjithë fansat të cilët kurrë nuk na lanë vetë, në çdo ndeshje, në çdo udhëtim dhe në çdo çast. Ju përqafoj të gjithëve dhe jeni në zemrën time përgjithmonë. Përjetësisht falënderues dhe me shumë dashuri", ka përfunduar Nuhiu. 31-vjeçari është paraqitur në 19 ndeshje për Kosovën dhe ka realizuar tre gola.

# Vashat e Kosovës arrin në Kosovë, priten nga drejtuesit e FVK-së

PRISHTINË, 16 MAJ - Përfaqësuesja e femrave e Kosovës në volejboll ka arritur në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari". Pas mbylljes së kualifikimeve në CEV EuroVolley 2021, Kosova është kthyer nga Nitra e Sllovakisë, duke u ndalur fillimisht në Vjenë, e pastaj në Prishtinë. Vashat e përfaqësueses janë pritur nga presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi. "Duke i uruar për paraqitjen, Gjinovci e Nikqi i kanë inkurajuar për punë e suksese edhe në të ardhmen. FVK-ja do ta mbështesë secilën prej përfaqësueseve dhe do ta japë maksimumin për prezantim të denjë të vlerave të volejbollit tonë", thuhet në njoftimin e FVK-së.



# Mitrovica fiton titullin e katërt të kampiones

MITROVICË, 16 MAJ - Skuadra e Mitrovicës është kurorëzuar me titullin e katërt të kampiones në Ligën e Femrave. Në ndeshjen e javës së fundit të kampionatit, Mitrovica është përballur në "Riza Lushta" me skuadrën e Jakovës, të cilën e ka mposhtur me rezultat të thellë 10:0. Në fakt, në këtë edicion të garave futbollistet e Mitrovicës kanë qenë të pakonkurrencë në garën për titull, duke i fituar 19 nga 20 ndeshjet e zhvilluara. Kjo ndeshje kishte karakter festues, pasi skuadra mitrovicase e kishte siguruar titullin më herët. Në ceremoninë e ndarjes së medaljeve dhe trofeut të kampionit morën pjesë kryetarja e Komisionit të Futbollit të Femrave, njëherësh anëtarja e KE të FFK-së, Vjollca Krasniqi, anëtari i KE-së nga rajoni i Mitrovicës, Xhelal Broja, administratorja e Ligës së Femrave, Valbona Gashi-Uka, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka dhe kryetari i LRF të Mitrovicës, Bardhec Seferi. Kësisoj, Mitrovica sërish do ta përfaqësojë Kosovën në garat e Ligës së Kampionëve.



## Milleri triumfon edhe në garën e Çmimit të Madh të Francës



LE MANS, 16 MAJ - Piloti australian Jack Miller me Ducati e fitoi sot garën e Çmimit të Madh të Francës në MotoGP të zhvilluar në pistën e Le Mans. Ai e nisi garën nga vendi i tretë, por arriti të rikuperojë dhe triumfojë, duke korrur suksesin e dytë sezonal. Kjo është gara e dytë radhazi që Milleri triumfon. Në vendin e dytë u rendit francezi Johann Zarco me Ducatin tjetër, ndërsa i treti u klasifikua francezi tjetër Fabio Quartararo me Yamaha. Pra, dy pilotë francezë ngjiten në podium në garën e shtëpisë. Një garë që nisi në pistë të lagur dhe me shi, por që u mbyll në pistë të thatë, duke bërë që pilotët t'i ndërrojnë motorët gjatë garës. Falë vendit të tretë në pistën e Le Mansh, Quartararo ngjitet në krye të renditjes provizore të MotoGP me 80 pikë, një më shumë se italiani Francesco Bagnaia. Një tjetër garë zhgënjyese e Valentino Rossit, që me Yamaha Petronas u rendit i 11-ti, ndërsa Marc Marquezi u rrëzua dhe u tërhoq.

# KHF Vushtrria, kampione e Kosovës në hendboll



ISTOG, 16 MAJ - Njomza Kelmendi ka bërë pritje vendimtare në sekondën e fundit për ta ndihmuar Vushtrrinë që ta fitojë titullin e kampiones në Superligën e Kosovës në hendboll. Vushtrria të shtunën mbrëma fitoi 22:21 ndaj Istogut në ndeshjen e tretë të finales së "play off"-it. Golin e fitores e shënoi Donita Kasumi. Ndeshja është luajtur në Istog, ndërsa Vushtrria me rezultat 2:1 në finale të "play off"-it shpallet kampione. Portierja Kelmendi, që ka bërë mbi dhjetë pritje, ndali gjuajtjet në fund për ta pamundësuar barazimin. Ndeshja ishte shumë e fortë e shumë dramatike. Vushtrriaset në fund kanë realizuar sulme rresht, sidomos nga alot, për ta shkrirë epërsinë e vendaseve. Në pjesën e dytë epërsia e Istogut shkoi deri në 4 gola, 21:17, por më pas vushtrriaset shënuan pesë gola rresht për ta fituar titullin. Luljeta Sopjani barazoi rezultatin në 21:21 në minutën e 59, kurse golin e fitores e shënoi Donita Kasumi në minutën e fundit. Esma Muratoviq shënoi 9 gola për Istogun, por që nuk mjaftuan. Te Vushtrria 6 gola i kishte Donita Kasumi, kurse nga 5 i kishin Luljeta Sopjani e Lorena Matarova. Por kontribut të madh për titull kanë dhënë të gjitha lojtaret duke nisur nga kapitenia Shqipe Tahiri, portierja Kelmendi, Burneta Rama, Kasumi, Sopjani, Matarova, Zade Zymeri e gjithë të tjerat. Natyrisht merita të mëdha ka trajneri Arben Parduzi. Kupën kapitenes Shqipe Tahiri ia dorëzoi nënpresidenti i FHK-së, Enis Idrizi.

# Lakersat mposhtin Indianan, San Antonio pëson humbje nga Phoenixi



INDIANAPOLIS, 16 MAJ - Los Angeles Lakersi rigjen, më në fund, dyshen LeBron James dhe Anthony Davies, të cilët udhëhoqën skuadrën kaliforniane drejt suksesit 122-115 në transfertën ndaj Indiana Pacersit dhe rritën ndjeshëm shanset për një vend në zonën "play-off" të renditjes. Dyshja që u ka munguar jo pak kampionëve në fuqi të NBA-it gjatë këtij sezoni u shfaqën në një formë të jashtëzakonshme, sidomos në fraksionin e parë të lojës, ku u vendos edhe rezultati final, kjo pasi Lakersat fituan pjesën e parë me shifrat 36-28, ndërsa fraksioni i dytë dhe i tretë përfunduan barazim. Vendasit e Indianës treguan një superioritet shumë të vogël në pjesën e fundit, por rikuperuan vetëm një pikë nga disavantazhi, duke mos ia dalë ta shmangin humbjen. Anthony Davies u shpall më i miri i ndeshjes me 28 pikë të shënuara, 10 topa të rikuperuar dhe pesë asistime, ndërsa edhe LeBroni te Lakersi e LeVert tek Indiana vendosën shifra mjaft të mira. Phoenix Suns vijon të besojë se mund ta marrë kryesimin në Konferencën e Perëndimit teksa këtë mbrëmje ka marrë një tjetër fitore bindëse, me rezultatin e thellë 103-140 në transfertën ndaj San Antonio Spursit. Gjithçka u vendos në gjysmën e parë të ndeshjes, pasi Sunsi fitoi fraksionin e parë me shifrat 34-17 dhe të dytin 41-23, duke siguruar një avantazh prej 42 pikësh, që i lejoi të ulë disi ritmin në pjesën e mbetur të lojës. Një tjetër fakt interesant është se plot 7 lojtarë të Phoenixit ia dolën të shkonin në kuotën dyshifrore të pikëve të shënuara, teksa protagonist absolut ishte Booker me 28 pikë, ndërsa Chris Paul nuk shkoi dot përtej 16 pikëve dhe 10 topave të rikuperuar. Brooklyn Netsi rigjen "Big Three" (Irvingu, Duranti e Hardeni) pas shumë kohësh dhe regjistron fitoren e katërt radhazi, këtë herë me rezultatin 105-91 në shtëpi ndaj Chicago Bullsit, duke forcuar pozitat në vendin e dytë renditjes në Konferencën e Lindjes. Netsi ia doli të fitojë veçanërisht falë paraqitjeve mjaft të mira në fraksionin e dytë dhe të katërt, ndërsa Chicago bie sërish pavarësisht prej formës së mirë të Patrick Williamsit dhe avantazhit fillestar 12-0 që në nisje të ndeshjes.

## SHKURT

### Barcelonës B nuk i mjaftojnë dy golat e Manajt

Barcelonës B nuk i kanë mjaftuar dy golat e shënuara nga sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Rey Manaj, për ta mposhtur Murcian në ndeshjen për barazh në Kategorinë e Tretë të Spanjës. Koha e rregullt përfundoi 2-2, ndërsa me të njëjtin rezultat përfunduan edhe shtesat. Pas penalltive, Barcelona B ka pësuar humbje me rezultatin 5:4. Manaj realizoi golin e parë nga penalltia në minutën e 46, ndërsa të dytin me një depërtim individual në minutën e 64-t, duke e marrë topin rreth 60 metra larg portës kundërshtare. Ai depërtoi duke kaluar disa mbrojtës kundërshtarë para se të realizonte.

### Nëse largohet Mbappe, PSG-ja transferon Lewandowskin

E ardhmja e Kylian Mbappes është e paqartë. Ylli francez ka kontratë deri në verën e vitit të ardhshëm me PSG-në që do të jetë e detyruar ta shesë nëse nuk vjen rinovimi. Real Madridi vazhdon të ushtrojë presion për ta blerë sulmuesin, ndërkohë që kampionët e Francës nuk duan të mbeten të papërgatitur dhe kanë piketuar pasardhësin e tij. "L'Equipe" raporton se PSG do ta nisë ofensivën për Robert Lewandowskin nëse Mbappe largohet. 32-vjeçari i Bayern Munchenit është një makineri golash, por nuk do të jetë aspak e thjeshtë për ta transferuar në kryeqytet.

### Alvesi rikthehet në Kombëtaren e Brazilit

Një lajm surprizues ka qarkulluar së fundmi në media. Bëhet fjalë për mbrojtësin Dani Alves i cili kthehet përsëri në kombëtaren e Brazilit. Zbulohet se 38-vjeçari, i cili aktivizohet me Sao Paolon, bën pjesë në listën e të grumbulluarve të trajnerit Tite për ndeshjet e ardhshme kualifikuese të Botërorit kundër Ekuadorit dhe Paraguait. "Alves po kalon një periudhë të mirë dhe ka një histori të gjatë në ekipin kombëtar. Në ndeshje të kualifikueseve të Botërorit nuk ka kohë për riaftësim dhe ai po luan në maksimumin e formës së tij fizike. Ka një aftësi të madhe drejtuese dhe kjo është shumë e mirë për grupin", ka deklaruar Tite duke konfirmuar kthimin pas dy vjetësh të futbollistit përsëri në kombëtare.

### Zidane do të largohet nga Reali, kush pritet të jetë trajneri i ri

Zinedine Zidane ka vendosur të largohet nga Real Madridi në fund të sezonit dhe vendimin e tij ua ka komunikuar lojtarëve. Para këtyre të fundit, vendimin e ka ditur vetë presidenti Florentino Perez, që tashmë po mendon për pasuesin e francezit dhe kërkimet e tij duket se janë drejtuar në një pistë të qartë. Në listën e pasuesve të Zidanes janë vetëm tre emra, por vëmendjen kryesore të presidentit e ka Max Allegri. Ish-trajneri i Juventusit prej dy sezonesh është i papunë. Fabrizio Romano raporton se ka pasur kontakte mes trajnerit dhe Perezit dhe Allegri e ka pranuar ofertën për ta drejtuar klubin e "Los Blancos". Përveç Allegrit, Rauli shihet si një opsion shumë i mirë.

## Bremeni shkarkon trajnerin

Klubi gjerman ku luan edhe Milot Rashica, Werder Bremeni, e ka shkarkuar trajnerin Florian Kohlfeldt. Ky vendim i kryesisë së klubit erdhi pas humbjes 0:2 ndaj Augsburgut. Kjo u bë e ditur nga drejtori sportiv Frank Baumann. "Ne jemi akoma të bindur që Florian Kohfeldt është një trajner i shkëlqyeshëm, por kemi rënë dakord të bëjmë një ndryshim tjetër në mënyrë që ta arrijmë përsëri rënien. Ne falënderojmë Florian për gjithçka që ai ka bërë për Werderin dhe i urojmë të gjitha të mirat", ka thënë Baumann. Ekipi i Rashicës ka caktuar si trajner të përkohshëm Thomas Schaaf, i cili e ka drejtuar skuadrën për disa vjet.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

ARKIVA MD / ARHIVA MD / ARCHIVE MD — DMB — 8273 — 12.05.2021

## NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
## OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34 , pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyruar e Tatimit.

Prema Zakonu br. 03 / L-222 Član 34, imovina opisana u nastavku oduzeta je zbog neplaćanja poreza, prinudnom naplatom poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar në "Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010 , neni 37.

Imovina će se prodati na aukciji zatvorenih ponuda, kako je regulisano u „Zakonu 03 / L-222 o Poreska administraciji i procedurama"i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen /: 25.05.2021 ora 11:00 Vendi i shitjes /: Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve.Veternik prapa Albi Mallë ngjitur me Doganë ,Rr.Hasan Hasani Nr 40- Prishtinë.
Ponude će biti otvorene / Ponude otvaraju se: 25.05.2021 u 11:00 Mesto prodaje / Mesto prodaje: Odeljenje za upravljanje naplate dugova, Veternik iza Albi Mall-a pored Carine, ul. Hasan Hasani br. 40- Priština.

Përshkrimi i Pasurisë /Opis imovine: N.P./PP "ACDC-KOS" SH.P.K/ DOO NF/FBR.810511643

1. Lokal Afarist me sipërfaqe 117-m2-Zona kadastrale-0-71914059-07588-5-11-49-P-2-0 Prishtinë,vendi-Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit – Prishtinë
   Poslovni prostor površine 117-m2-Katastarska zona-0-71914059-07588-5-11-49-P-2-0 Priština, mesto-Bulevar narodnih heroja - Priština.
   Lloji i njësisë-Pjesa e Ndërtesës ,Kati P,(Vendi i Quajture-Kalabria)
   Tip jedinice - deo zgrade, sprat P, (mesto nazvano-Kalabrija)
2. Lokal Afarist me sipërfaqe 31 m2 - Adresa-Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit – Prishtinë.Njësia kadastrale -0-71914059-07588-5-1149-P-3-0,Zona katastarele – Prishtinë, Poslovni prostor površine 31 m2 - Adresa-Bulevar narodnih heroja - Priština Katastarska jedinica -0-71914059-07588-5-1149-P-3-0, Katastarska zona - Priština,
   Lloji i njësisë-Pjesa e Ndërtesese ,Kati P,(Vendi i Quajture-Kalabria)
   Tip jedinice - Deo zgrade, sprat P, (mesto nazvano-Kalabrija)
3. Lokal Afaristë me siperfaqe 88 m2- Adresa-Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit – Prishtinë.Njësia katastrale-071914059-07588-5-1149-P-4-0,Zona katastrale –Prishtinë, Poslovni prostor površine 88 m2 - Adresa-Bulevar narodnih heroja - Priština Katastarska jedinica-071914059-07588-5-1149-P-4-0, Katastarska zona - Priština,
   Lloji i njësise- Pjesa e Ndërtesësë,Kati P,(Vendi i Quajture-Kalabria)
   Tip jedinice - Deo zgrada, sprat P, (mesto nazvano Kalabrija)

**Çmimi fillestarë për Lokalin me numër:** 07588-5-11-49-P-2-0 **është 2500€ për një metër katrorë**
**Početna cena za prostor sa brojem: 07588-5-11-49-P-2-0 iznosi 2500 € po kvadratnom metru**
**Çmimi fillestarë për lokalin me numër:07588-5-1149-P-3-0, është 2500€ për një metër katrorë**
**Početna cena za prostor sa brojem: 07588-5-1149-P-3-0 iznosi 2500 € po kvadratnom metru**
**Çmimi fillestarë për Lokalin me numër: 07588-5-1149-P-4-0 është 2500€ për një metër katrorë**
**Početna cena za prostor sa brojem: 07588-5-1149-P-4-0 iznosi 2500 € po kvadratnom metru**

**Kushtet e pjesëmarrjes**: kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancia bankare) në shumën 10% të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.
**Uslovi učešća:** Uslovi učešća u licitaciji, kada se radi e nepokretnoj imovini, je avans (bankarska garancija) u iznosu od 10% neisplaćenih poreskih obaveza poreskog obveznika.
**Paraqitja e Ofertave:** Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.
**Dostavljanje ponuda:** Sve ponude jasno identifikuju ponudjenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu, i broj bankarskog računa pojedinca ili entiteta koji dostavlja ponudu treba da se primaju u zatvoreni pliko (koverat) pre gore specificiranog datuma i vremena.
**Pasuria mund të inspektohet në:**
Çdo dite pune prej orës 9:00 deri 15:00 nga data.14.05.2021 deri më datën 21.05.2021 dhe mund të kontaktoni personat zyrtar në tel mobil: 044-189-413; 044-354-276; 043-877-877.
**Imovina se može pogledati:**
Svakog radnog dana od 9:00 do 15:00 od 14.05.2021 do 21.05.2021, a službenike možete kontaktirati na mobilni telefon: 044-189-413; 044-354-276; 043-877-877
Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska administracija Kosova

Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve-Prishtinë
Direkcija za upravljanje naplatom dugova

Data: 12 Maj 2021

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "AS HOME" L.L.C. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811488940 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AS HOME" L.L.C.donelo odluku o prestani rada sa nr. 811488940, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "AS HOME" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811488940, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Ligji Nr. 06/L -016, konform nenit 112 paragrafi 1,2,3,4 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Sik Kosovo Sh.p.k. me numër unik identifikues (NUI) : 811433482 me seli në rruga 'Hasan Prishtina' p.n.,, Komuna Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin dhe ka caktuar likuidatorin Ilir Berisha me ID: 1013510829 nga Obiliq, Adresa: Rruga 'Hasan Prishtina' p.n. me tel: 044/199-106 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të parealizuara dhe raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.










Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Trofta Fresh" Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan , në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hurdhën për rritjen e peshkut në Dobërçan, Gjilan.
Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.06.2021 në ora 11:00 në Restaurant Planeti ne hyrje te Gjilanit do të organizohet debat publik nga Kompania "Trofta Fresh" Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Dobërçan, Gjilan Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOm Linku:
https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhjS3lKdEVTV1F0

NTFvZz09
Meeting ID: 966 277 1284
Passcode: 112233

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Trofta Fresh" Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan për Dobërçan, Gjilan
https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Hilmo Maksuti shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren..

▶ Detart Grajçevci shpall të pavlefshme ID-kartelen e lëshuar nga Kolegji AAB, Prishtinë.

▶ Idriz Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.

▶ Ibrahim Kroni shpall të pavlefshme dëftesën e vitit III shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues




ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA